




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK. Nr. 249/2019**  
**Datë: 12 dhjetor 2019**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.12, 1.17 dhe 1.25, nenit 13 paragrafi 1, pika 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 9 paragrafi 1 të Rregullores për Organizimin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen nr. 227-të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

## **V E N D I M**

- I. Aprovohet dorëheqja e z. Nehat Idrizi, nga funksioni i Anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
- II. Z. Idrizi, pas dorëheqjes nga funksioni i Anëtarit të KGJK-së, i pushojnë të gjitha detyrat dhe përgjegjesitë që ndërlidhen me detyrat e anëtarit të KGJK-së.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.

## **A r s y e t i m**

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me datë 15 nëntor 2019, nga anëtari i KGJK-së z. Nehat Idrizi, ka pranuar dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Këshillit.

Z. Idrizi, përmes shkresës së tij njofton se për arsye personale dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, jep dorëheqje nga funksioni i anëtarit të KGJK-së.

Z. Idrizi, është emëruar anëtarë i Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 26 shkurt 2015, në bazë të Vendimit Nr. 05-V-024, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me mandat pesë (5) vjeçar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, ka shqyrtuar dhe aprovuar dorëheqjen e z. Idrizi, nga funksioni i anëtarit të KGJK-së.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

The seal is circular with a blue border. The outer ring contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS' at the top and 'KESHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUBSKRIPET KOSOVA' at the bottom. In the center is the coat of arms of Kosovo, featuring a map of the country and a sun. To the right of the seal is a blue ink signature.  
Skender ÇOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- *Nehat Idrizi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Kosovës;*
- *Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- *Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivit.*